



FORUMI 2023

---

Sfidat dhe Mundësitë e  
Fëmijëve dhe të Rinjve  
në Shoqëri

---

DHJETOR 2023



Funded by  
the European Union






Publikimi:  
Domovik  
Sutjeska pn, Mitrovicë e Veriut  
E-mail: [office@domovik.org](mailto:office@domovik.org)  
[www.domovik.org](http://www.domovik.org)



Ky publikim është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OJQ Domovik dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.


OJQ Domovik mbështetet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosova', i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.





## PËRMBAJTJA

<b>Përmbledhje e forumit 2023 . . . . .</b>	<b>6</b>
<b>Objektivat e Forumit . . . . .</b>	<b>11</b>
<b>Pikat kryesore . . . . .</b>	<b>12</b>
<b>Folësit e Panelit mbi</b>	
<b>    Arsimin . . . . .</b>	<b>12</b>
<b>Folësit e Panelit mbi</b>	
<b>    Hapësirën Qytetare . . . . .</b>	<b>14</b>
<b>Folësit e Panelit mbi</b>	
<b>    Ekologjinë . . . . .</b>	<b>16</b>
<b>Folësit e Panelit mbi</b>	
<b>    Shëndetin Mendor . . . . .</b>	<b>18</b>
<b>Rekomandimet . . . . .</b>	<b>20</b>
<b>Konkluzioni . . . . .</b>	<b>23</b>



## PËRMBLEDHJE

Ky raport është hartuar pas përfundimit të Forumit 2023: Sfidat dhe Mundësitë e Fëmijëve dhe të Rinjve në Shoqëri, të organizuar nga OJQ Domovik në Mitrovicën e Veriut, më 29 dhe 30 nëntor 2023. Mbi 90 persona morën pjesë në këtë aktivitet për dy ditë. Forumi përbëhej nga katër panele, të cilët u ndanë sipas temave: hapësira qytetare, arsimi, shëndeti mendor dhe ekologjia, të gjitha me fokus mbi fëmijët dhe të rinjtë. Në panelet e diskutimeve folën ekspertë dhe aktivistë nga fushat e lartpërmendura.

Miljan Stanishiq, koordinator i programit në organizatën OJQ Domovik, përshëndeti ngrohtësisht të gjithë të pranishmit në emër të organizatës dhe prezantoi punën e tij. Që nga viti 2009, Domoviku ka punuar vazhdimisht për të përmirësuar pozitën e të rinjve dhe

fëmijëve, dhe fokusi i punës është në sfidat e së ardhmes së brezave të rinj në komunitetin e tyre.

U theksua edhe qëllimi i mbajtjes së Forumit dhe vizioni i tij. Ngjarja e parë e fillë u mbajt dy vite më parë në Zubin Potok. Tema e përgjithshme e Forumit ishte e ngjashme me atë të këtij viti - sfidat dhe mundësitë me të cilat përballen të rinjtë dhe fëmijët në komunitetet e tyre.

Forumit 2023 mbledhi së bashku pjesëmarrës nga pjesë të ndryshme të rajonit, duke përfshirë ekspertë që kontribuojnë në nivel lokal dhe ata që vijnë nga një kontekst më i gjerë rajonal. Kjo ishte një mundësi që ata të paraqisnin pikëpamjet e tyre dhe të eksploronin së bashku problemet, sfidat dhe mundësitë që kanë të bëjnë me fëmijët dhe të rinjtë.





Në panelin e parë, folësi hapës ishte Marjan Cvetkoviq, një aktivist rinor dhe ish-drejtor i Organizatës ombrellë të të rinjve në Serbi, i cili e theksoi rëndësinë e aktivizmit që synon komunitetet lokale dhe përshtatjen e ndryshimeve me nevojat e të rinjve. Ai theksoi se problemi më i madh i të rinjve është mungesa e informacionit dhe theksoi nevojën për iniciativa avokuese, qëllimi i të cilave do të ishte zhvillimi i Info Qendrave që do t'u siguronin të rinjve informacion të saktë.

Svetlana Balldini, psikologe që përfaqëson organizatën Caritas Kosova, foli për punën me fëmijët romë, duke theksuar problemet me të cilat përballen, siç janë: kushtet e këqija të jetesës, papunësia, vështirësitë në arsim dhe mungesa e dokumentacionit. Puna e saj është e fokusuar në ofrimin e mbështetjes për fëmijët dhe prindërit romë nëpërmjet punëtorive edukative, vaksinimeve dhe ndihmës në arsim.

Panelistja tjetër, Aida Krasniqi, anëtare e grupit të të rinjve UM, ndau përvojën e saj nga këndvështrimi i aktivistes në komunitetin rom dhe foli për filmin për martesat e hershme mes romëve, të cilin e xhirooi së bashku me anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilët e njohën rëndësinë e aktivizmit. Në fund të prezantimit të saj, ajo u bëri thirrje të gjithë të rinjve që të jenë nismëtarë të ndryshimeve që duan t'i shohin.

Panelisti i fundit ishte Kushtrim Gjoshaj, Menaxher i Programit në OJQ Community Building Mitrovica (CBM). Ai foli për pajtimin e të rinjve serbë dhe shqiptarë, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes së të rinjve, dëgjimit të nevojave të tyre dhe veprimit të përbashkët me qëllim të tejkalimit të hendekut etnik dhe promovimit të gjithëpërfshirjes. Të gjithë folësit u pajtuan se është thelbësore të ofrohet mbështetje për të rinjtë, të zhvillohen programe dhe aktivitete gjithëpërfshirëse dhe të punohet në mënyrë aktive për të kapërcyer sfidat me të cilat përballen të rinjtë.





Në panelin e dytë të ditës së parë të Forumit, të pranishmit patën mundësinë të dëgjojnë për rëndësinë e edukimit nga prof. Dr. Tatjana Kompiroviq, e cila foli për historikun e zbatimit të masave ligjore për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës. Ajo shpjegoi sfidat me të cilat përballlemi sot, duke theksuar dallimin ndërmjet kornizës ligjore dhe situatës reale, duke i ilustruar ato me shembuj të masave afirmative në Fakultetin Filozofik në Mitrovicë.

Ivana Millosavljeviq, Udhëheqëse e Zyrës Zonale të UNICEF-it për rajonin e Mitrovicës, pedagoge e diplomuar, theksoi rëndësinë e mbledhjes dhe analizës sistematike të të dhënave. Ajo theksoi veçanërisht sfidat me të cilat përballen ata që kanë vështirësi për qasje në arsim, veçanërisht në zonat rurale.

Folësja e fundit, Miljana Bullatoviq, Drejtoreshë e Organizatës Joqeveritare Art Punkt Akvarijus, pikto-re dhe psikologe e diplomuar, foli për rëndësinë e arsimit joformal dhe informal. Fokusi i prezantimit të saj ishte zhvillimi i të menduarit kritik tek fëmijët dhe të rinjtë, i cili inicihet përmes artit dhe proceseve krijuese. Ajo gjithashtu theksoi se, megjithëse në dekadat e fundit po flitet në mënyrë intensive për arsimin joformal, ai shpesh nuk njihet mjaftueshëm si pjesë e rëndësishme e sistemit arsimor.

Paneli i paradites në ditën e dytë të Forumit 2023 kishte të bënte me shëndetin mendor. Simona Gjuroviq, psikologe dhe psikoterapiste familjare, Mbikëqyrëse në Qendrën për Punë Sociale në Zubin Potok, theksoi rëndësinë e madhe të shëndetit mendor të fëmijëve dhe të rinjve, duke theksuar rëndësinë e promovimit të këtyre temave përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, në mënyrë që të inkurajohet kërkimi i ndihmës dhe mbështetjes. Bashkëbiseduesja tjetër, prof. Dr. Jellena Miniq, psikologe dhe psikoterapiste sistematike familjare, foli për mitet dhe paragjykimet që lidhen me problemet mendore në shoqëri, duke theksuar nevojën për mbështetje sistematike për të përmirësuar shëndetin mendor të të rinjve dhe fëmijëve.

Isidora Jovanoviq, studente në Fakultetin e Mjekësisë dhe Redaktore e Platformës Rinore Leaderonline në organizatën Domovik, ndau përvojën e saj personale dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë kur paraqesin sfida mendore. Përveç kësaj, ajo prezantoi të dhëna interesante të marra nga hulumtimi për shëndetin mendor të të rinjve, i cili u krye nga Domovik.

Rekomandimi kryesor i këtij paneli është nevoja për edukimin e të gjithë aktorëve në sistemin mbështetës, përfshirë prindërit, pedagogët, psikologët dhe edukatorët në kopshtet e fëmijëve, u pajtuan të gjithë panelistët. Sipas tyre, informacioni dhe mbështetja në kohë për të gjithë brenda sistemit e luan një rol kyç.





Panelli i fundit, tema e të cilit ishte ekologjia, filloi me fjalimin e Jellena Gjokiqit, profesoreshës në Fakultetin e Shkencave Teknike në Mitrovicë, e cila e theksoi rëndësinë kryesore të studimit të mbrojtjes së mjedisit, duke paraqitur një tematikë të gjerë që përfshin lënda e saj. Ajo u fokusua në elementë kritikë si ndotja e ajrit, ujit dhe tokës, ndërsa theksoi risitë teknologjike për trajtimin e mbeturinave. Profesoresha Gjokiq theksoi domosdoshmërinë e kontrollit dhe vlerësimit të rreziqeve mjedisore, duke hetuar implikimet për burimet njerëzore dhe të mirat materiale në situata të fatkeqësive natyrore.

Ajo theksoi veçanërisht nevojën për sensibilizimin e qytetarëve, duke kërkuar të shikohet pasqyra reale e gjendjes aktuale të ndotjes dhe bëri thirrje për veprim aktiv, duke theksuar se është e nevojshme të vihen në dukje pasojat e rënda për mjedisin, nëse nuk ndërmerren hapa urgjent për ruajtjen e mjedisit. Gjatë prezantimit të tij, Masteri i Ekologjisë, Nikolla Grujiq paraqiti hulumtime ekologjike që synojnë të analizojnë gjendjen e mjedisit në rajonin e Mitrovicës. Fokusi i hulumtimit të tij ishte në rrjedhën e mesme të lumit Ibër, ndërsa rezultatet i kishte paraqitur në mënyrë të detajuar në temën e masterit me titull "Vlerësimi biologjik i cilësisë së rrjedhës së mesme të lumit Ibër, duke iu referuar


gjendjes së mjedisit në rajonin e Mitrovicës". Ai të pranishmëve u prezantoi konkluzione shqetësuese për ndotjen e lumenjve dhe tokave në këtë rajon.

Gjithashtu, ai vuri në dukje zhvillimin e pamjaftueshëm të vetëdijes së njerëzve për këto probleme dhe theksoi nevojën për rritje të përpjekjeve në fushën e arsimit dhe ndërgjegjësimit për sfidat mjedisore. Ai posaçërisht e theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me sektorin civil, duke theksuar se është i lumtur që shikon përfshirjen dhe njohuritë e pjesëtarëve më të rinj të komunitetit mbi këtë çështje. Panelistja Maja Kociq, Këshilltare për Menaxhimin e Projekteve në Administratën e Qytetit të Leskovcit, gjatë prezantimit të saj foli në detaje për projektet e realizuara në komunën e saj, dhe theksoi nevojën e intensifikimit të projekteve për mbrojtjen e mjedisit dhe se komunat duhet të ndajnë më shumë mjete për këto aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e mjedisit.

Maja e ndau një shembull të praktikës së mirë, duke treguar një situatë ku një grup qytetarësh arritën të ndalonin ndërtime pa leje të një ndërtese me protestat e tyre. Kjo nismë kontribuoi në ruajtjen e zonave të gjelbra në komunitet, e cila shërbeu si frymëzim dhe nxitje për qytetarët e tjerë që të përfshihen aktivisht në mbrojtjen e mjedisit. Puna e saj ilustron se si angazhimi i përbashkët mund të ketë një ndikim pozitiv në mjedisin lokal dhe tregon rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset e ruajtjes së natyrës.







## OBJEKTIVAT E FORUMIT

Programi i Forumit 2023 “Sfidat dhe Mundësitë e të Rinjve në Shoqëri” kishte për qëllim përmbushjen e objektivave të mëposhtme:

**Rritja e ndërgjegjësimit:** Fuqizimi i pjesëmarrësve të Forumit për  
○ rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në shoqëri, ndërgjegjësimi për çështjet kyçe që lidhen me fëmijët dhe të rinjtë.

**Shkëmbimi i përvojave dhe njohurive:** Mundësimi i shkëmbimit të  
○ ideve, përvojave dhe praktikave më të mira në fushat e aktivizmit, vullnetarizmit, ekologjisë, shëndetit mendor, edukimit dhe përfshirjes ndërmjet ekspertëve, organizatave dhe fëmijëve dhe të rinjve.

**Identifikimi i sfidave:** Identifikimi i sfidave kryesore me të cilat  
○ përballen fëmijët dhe të rinjtë në shoqërinë e sotme, duke përfshirë aspektet mjedisore, shëndetësore e mendore, arsimore dhe aspekte të tjera sociale.

**Dhënia e rekomandimeve:** Formulimi i rekomandimeve dhe  
○ strategjive konkrete për zgjidhjen e sfidave të identifikuara dhe krijimin e mundësive për përmirësimin e kushteve të jetesës së të rinjve dhe fëmijëve.

**Krijimi i një platforme për ndryshim:** Krijimi i një platforme për përfshirjen aktive të fëmijëve dhe të rinjve në procesin e vendimmarrjes dhe formësimit të politikave që kanë të bëjnë me nevojat dhe interesat e tyre.


**Nxitja e gjithëpërfshirjes:** Promovimi i përfshirjes, jo vetëm në fushën e arsimit, por edhe në aktivizëm, angazhimin qytetar  
○ dhe në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, për të siguruar që të gjithë të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe për t'u dëgjuar.

**Edukimi dhe fuqizimi:** Edukimi dhe fuqizimi i të gjithë  
○ pjesëmarrësve të Forumit mbi rëndësinë e arsimit joformal, si dhe praktikat gjithëpërfshirëse të cilat mundësojnë që të gjithë të zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre.

Këto objektiva duhet të mbështesin procesin e mirëkuptimit, veprimit dhe ndryshimeve që synojnë krijimin e një mjedisi pozitiv për të rinjtë dhe fëmijët në rajonin tonë, duke marrë parasysh një gamë të gjerë të nevojave dhe sfidave të tyre në shoqëri.




## PIKAT KRYESORE



### FOLËSIT E PANELIT MBI ARSIMIN


Fakulteti nuk ka kushtet më adekuate për sa i përket teknologjisë ndihmëse apo aftësimin të mësuesve për të punuar me studentë të tillë dhe as nuk është e rregulluar me ligje dhe akte nënligjore. Prandaj, theksoj se ndonjë iniciativë, ndoshta edhe nga sektori civil, mund të shkojë në atë drejtim për të ndryshuar gjëra të tilla në të ardhmen.



**Tatjana Kompiroviq** – profesoreshë e asociuar, departamenti i pedagogjisë, Fakulteti Filozofik




Problemi kryesor për komunitetin është mbledhja sistematike e të dhënave të cilat mund të gjenden në një vend, gjë që do të lehtësonte shumë përfshirjen e fëmijëve të marginalizuar në sistemin arsimor.



**Ivana Millosavljeviq** - Udhëheqëse e Zyrës Zonale të UNICEF-it për rajonin e Mitrovicës



Është e rëndësishme të theksohet se diskriminimi, mospërfshirja, moskuptimi i opinionëve dhe mendimeve të fëmijëve dhe të rinjve, si nga ana e prindërve, ashtu edhe nga ana e institucioneve, janë diçka që do të jetë një problem që do ta zgjidhim për shumë vite. Prandaj, çdo ditë përballemi me faktin se në arsimin formal, në institucionet shkollore, universitetet dhe të gjitha programet e tjera arsimore, kemi diskriminim qartë të definuar.



**Miljana Bullatoviq** - Drejtoreshë e Art Punkt Akvarijus, piktore dhe psikologe e diplo-



## FOLËSIT E PANELIT MBI HAPËSIREN QYTETARE



Unë personalisht besoj se puna jonë duhet të bazohet në informimin e fëmijëve dhe të rinjve. Një numër i madh i të rinjve janë të vetëdijsëm se kanë nevojë për informacion, por nuk dinë ku ta kërkojnë atë. Çdo komunitet lokal duhet të ketë diçka si një Qendër Informimi dhe ajo Qendër Informimi duhet të ndihmojë të riun të vazhdojë në rrugën e duhur. Ndodh shpesh që të rinjtë, sidomos ata që janë të ndrojtur dhe nuk janë mjaft të guximshëm, të mbeten pa informacion ose të hasin në informacione sipërfaqësore apo dezinformata. Kjo rezulton me pasoja si pasiguria, papunësia etj. Si shoqëri, si sektor civil, si organizata, si individë duhet të punojmë shumë më tepër në atë fushë, në mënyrë që informacioni të jetë i qasshëm për të rinjtë.

**Marjan Cvetković** - Aktivist rinor, ish-drejtor i Organizatës ombrellë të të rinjve në Serbi


Shoqëria si institucion duhet t'i njohë romët dhe t'u ofrojë atyre mbështetje gjithnjë e më të mirë dhe kualitative, jo vetëm në letër, por edhe në realitet. Këtu kam parasysh shkallën e punësimit, aktivizimin në flukset sociale, përfshirjen, të jenë në shkolla të përziera. Ata nuk janë aspak të ndryshëm në raport me fëmijët tanë dhe në raport me ne në përgjithësi. Ne duhet të respektojmë njëri-tjetrin, të kuptohemi dhe të jetojmë së bashku.



**Tatjana Baldini** - psikologe-këshilltare në projekt në Caritas




Është krejtësisht në rregull nëse nuk dini diçka, por nuk është në rregull nëse nuk përpiqeni ta ndryshoni atë. Ne duhet të jemi ndryshimi për veten tonë dhe më pas mund të ndryshojmë botën. Të jemi versioni më i mirë i vetes dhe shembulli më i mirë për njerëzit rreth nesh. Ne e kuptojmë se suksesi nuk matet vetëm nga ajo që keni arritur në jetë, por edhe nga fakti nëse i keni frymëzuar të tjerët për të bërë diçka.




**Aida Krasniqi** - nxënëse e vitit të katërt të Shkollës së Mjekësisë dhe anëtare e grupit të të

Ne duhet t'u ofrojmë mbështetje të rinjve, t'i dëgjojmë, t'u hapim dyert dhe në një farë mënyre të financojmë aktivitetet e tyre. Nuk duhet t'i humbasim të rinjtë. Në jug pashë mungesë shprese tek të rinjtë. Shumë prej tyre duan të largohen nga Kosova. Ne nuk duam t'i humbim këta të rinj dhe do t'i humbasim nëse thjesht vetëm u themi 'Po, ne ju duam'. Kjo nuk mjafton. Duhet edhe t'i mbështesim dhe t'u themi se janë shumë të rëndësishëm për këtë komu-



**Kushtrim Gjoshaj** - Menaxher për zhvillimin e Programit në OJQ CBM



## FOLËSIT E PANELIT MBI EKOLOGJINË


Mesazhi im për të rinjtë është të punojnë për veten e tyre, të zhvillohen, të bashkohen dhe të jenë të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë ata forcojnë zërin e tyre në publik. Jeta e tyre duhet të jetë në duart e tyre. Mjedisi nuk është çështje zgjedhjeje apo prestigji, por e ekzistencës së komunitetit, në çfarëdo rendi shoqëror që të jetë. Mjedisi është një çështje përtej përkatësisë kombëtare dhe fetare apo fuqisë ekonomike. Jini të hapur me të gjithë ata që janë në të njëjtën detyrë, kërkoni ndihmë, kërkoni mbështetje! Shumë më tepër mund të varet nga ju sesa duket tani. Ju uroj suksese në misionin tuaj për një të ardhme të shëndetshme!

**Maja Kociq** - Këshilltare për Menaxhimin e Projekteve në Administratën e Qytetit të Leskovcit






Rekomandimi im është që të rinjtë t'i marrin gjërat në duart e tyre dhe të arsimohen. Mësoni, angazhohuni dhe mos ktheni kokën pas për të parë nëse dikush do të qëndrojë pas jush. Shkoni vetëm, hapni rrugën tuaj, punoni shumë sepse cilësia njihet gjithmonë. Nuk ka se si të ndihmoni dikë që nuk ka cilësi por edhe nuk ekziston mënyra se si të shtypet cilësia e dikujt. Cilësia gjithmonë del në pah. Punoni dhe përpiquni.




**Jellena Gjokiq** - profesoreshë në Fakultetin e Shkencave Teknike në Mitrovicë



Dëshiroj t'u përcjell një mesazh të rinjve që të krijojnë një lidhje me mjedisin e tyre. Për të zhvilluar dashurinë për lumin, pyllin, kodrën ose qytetin tuaj, hapi i parë është t'i hulumtoni me kujdes dhe t'i njihni ato. Kur ata të njohin vërtet mjedisin e tyre, do të bëhet një lidhje autentike, duke i frymëzuar ata të ruajnë dhe përmirësojnë mjedisin e tyre.



**Nikolla Grujiq** - Master i Ekologjisë



## FOLËSIT E PANELIT MBI SHËNDETIN MENDOR

Ne po i dërgojmë një mesazh të gjithëve që dëgjojnë se është shumë mirë të kërkojmë ndihmë psikologjike, ashtu siç është normale ta kërkojmë atë në çdo gjendje tjetër kur kemi nevojë për të. Dhe që të gjithë mund të na dëgjojnë nga këtu sot - se nuk ka asgjë të keqe të shkosh te një psikolog, nëse nuk mund të përballojnë diçka, se kanë me kë të flasin, se shoqëria nuk do t'i gjykojë. Është e qartë se shëndeti mendor duhet të jetë një prioritet për të gjithë ne dhe se problemet tuaja janë të rëndësishme, pavarësisht nga shkaku i tyre.




**Simona Gjuroviq** – psikologe dhe psikoterapiste familjare, Mbikëqyrëse në Qendrën për Punë Sociale në Zubin Potok



U takon të rinjve të gjejnë një mënyrë për t'u përballur me sfidat që dalin në çdo moment të periudhës së zhvillimit. Për të rritur ndërgjegjësimin për shëndetin mendor, ata duhet të angazhohen për të informuar dhe krijuar një mjedis të sigurt që do të motivojë të gjithë ata që përballen me probleme, që të flasin lirshëm dhe hapur për to. Përhapjen gjithmonë e më të madhe të teknologjisë dhe mediave sociale duhet ta përdorim për të parandaluar dhe promovuar shëndetin mendor.

**Isidora Jovanoviq** – studente në Fakultetin e Mjekësisë dhe Redaktore e Platformës Rinore Leader online në OJQ Domovik





Problemet e shëndetit mendor duhet të vështrohen në një kontekst më të gjerë, familjar dhe sistematik, sipas parimit të komunitetit lokal. Rreziqet për shëndetin mendor janë të mëdha. Gjithmonë ka pasur. Dua të them se shëndeti mendor, të paktën nga këndvështrimi im, nga praktika terapeutike dhe monitorimi i rezultateve të kërkimeve më të fundit, është i kërcënuar në të gjithë planetin. Lajmi i mirë është se njerëzit janë më të hapur për t'u drejtuar te psikologët dhe psikoterapistët për ndihmë. Ka paragjykime dhe stereotipe të panumërta për të shkuar te një psikoterapist. Megjithatë, njerëzit harrojnë se ndihma më e madhe psikologjike është në parandalimin e problemeve më të mëdha. Në veçanti duhet theksuar rëndësia e shëndetit mendor të fëmijëve të vegjël në fëmijërinë e hershme. Ajo fraza “do të kalojë” kushton shumë më vonë, në kuptimin që ikin vitet vendimtare për ndërhyrje. Për këtë arsye ne përpiqemi të punojmë në sensibilizimin e prindërve, që të lajmërohen në kohë dhe sa më shpejt. Ajo është koha kur është e nevojshme të ndërhyhet në disa vështirësi zhvillimore me të cilat përballet fëmija. Shumë shpesh, këto vështirësi dhe probleme zhvillimore zgjidhen, nëse prindërit lajmërohen në kohë. Në këso raste koha nuk bën asgjë, por është ajo që ne bëjmë gjatë asaj kohe, gjegjësisht me atë kohë.

**Jellena Miniq** – psikologe dhe psikoterapiste sistematike familjare



## REKOMANDIMET

**Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet akterëve rajonalë:** Inkurajimi i bashkëpunimit të mëtejshëm midis ekspertëve vendorë dhe rajonalë mundëson ndarjen e praktikave, burimeve dhe ideve më të mira për të adresuar në mënyrë efektive sfidat me të cilat mund të përballen të rinjtë dhe fëmijët.

**Partneritetet me sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile:** Zhvillimi i partneriteteve me sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile mund të forcojë mbështetjen dhe burimet e nevojshme për zbatimin e programeve dhe projekteve që trajtojnë aktivizmin, arsimin, shëndetin mendor dhe çështjet mjedisore. Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve përkatës, duke përfshirë institucionet arsimore, agjencitë qeveritare, sektorin joqeveritar dhe komunitetin, duhet të inkurajohet për të siguruar koordinim dhe bashkëpunim në përmirësimin e qasjes në arsim për fëmijët e marginalizuar.

**Mbështetja e qasjeve gjithëpërfshirëse:** Promovimi i gjithëpërfshirjes në arsim, shoqëri dhe aktivitete që rritin diversitetin për të siguruar që të gjithë të rinjtë, pavarësisht nga prejardhja, aftësia ose statusi socio-ekonomik, të kenë qasje në burime dhe mundësi.





**Baza e të dhënave e centralizuar:**

Zhvillimi i një bazë të dhënash të centralizuar që përmban informacion mbi fëmijët e marginalizuar dhe nevojat e tyre arsimore. Kjo do të mundësonte një kuptim më të mirë të situatave të tyre dhe identifikimin më të lehtë të qasjes në arsim.

**Qasja e integruar:** Sigurimi që kjo bazë të dhënash të jetë e qasshme për institucione të ndryshme përkatëse, si shkolla, kopshte, shërbime sociale dhe organizata të tjera që merren me arsimin dhe mbështetjen për fëmijët.

**Standardizimi dhe monitorimi i të dhënave:** Zhvillimi i standardeve për mbledhjen e të dhënave për fëmijët e marginalizuar për të siguruar vazhdimësi dhe besueshmëri të informacionit. Është gjithashtu e rëndësishme që rregullisht të përditësohen dhe monitorohen këto të dhëna në mënyrë që të identifikohen ndryshimet dhe të përshtaten strategjitë mbështetëse.

**Trajnim dhe mbështetje për profesionistët:** Sigurimi i trajnimeve dhe mbështetjes për profesionistët që punojnë me grupe dhe fëmijë të marginalizuar, për ta përdorur në mënyrë efektive këtë informacion në praktikë dhe për të përshtatur qasjet dhe metodat e tyre të të mësuarit.

**Përmirësimi i kushteve për gjithëpërfshirje:**

Përmirësimi i kushteve për arsimin gjithëpërfshirës, veçanërisht për studentët me aftësi të kufizuara ose aftësi të tjera të kufizuara. Kjo përfshin sigurimin e mjeteve të përshtatshme teknologjike dhe trajnimit për mësuesit për të mbështetur këta studentë.


**Iniciativat për ndryshim:** Mbështetja e iniciativave që vijnë nga sektori civil për përmirësimin e kushteve dhe praktikave në sistemin arsimor për fëmijët nga komunitetet e margjinalizuara. Kjo mund të përfshijë kërkesat për ndryshime të akteve ligjore nënligjore.


**Avancimi i arsimit joformal:** Promovimi i arsimit joformal si një proces i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm që mund të ketë ndikim pozitiv në grupe të ndryshme, duke përfshirë të moshuarit, delikuentët dhe ata që e kanë ndërprerë arsimin formal.

**Tejkalimi i paragjytimeve:** Është e rëndësishme të punohet për të kapërcyer paragjykimet dhe stigmatizimin lidhur me shëndetin mendor, në mënyrë që të lehtësohet qasja në mbështetje psikologjike dhe të promovohet rëndësia e mbështetjes sociale.

**Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve:** Mbështetja e fushatave që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e shëndetit mendor.

**Ndërgjegjësimi mjedisor:** Theksi në edukimin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e shëndetit mjedisor, veçanërisht duke u fokusuar në zgjidhjen e problemit të ndotjes së ajrit dhe ndikimin e tij të drejtpërdrejtë në shëndet.





## KONKLUZIONI

Ky aktivitet dyditor ishte një hap kyç në diskutimin e sfidave dhe mundësive të fëmijëve dhe të rinjve në shoqëri. Forumi u nda në katër panele që mbuluan temat e hapësirës qytetare, arsimit, shëndetit mendor dhe ekologjisë, me fokus fëmijët dhe të rinjtë.

Duke u kthyer pas në ditën e parë të Forumit, panelistët theksuan rëndësinë e informimit të të rinjve dhe përshtatjes së ndryshimeve me nevojat e tyre. Janë paraqitur shembuj të punës me fëmijët romë, si dhe shembuj të aktivizmit të të rinjve në komunitet. Në ditën e dytë, fokusi ishte në shëndetin mendor dhe ekologji. Folësit prekën problemin e mungesës së informacionit për shëndetin mendor të të rinjve dhe nevojën për mbështetje sistematike. Gjithashtu, u theksua rëndësia e arsimit joformal dhe artit në zhvillimin e të menduarit kritik tek fëmijët dhe të rinjtë.

Në diskutime u theksua shpeshherë rëndësia e edukimit të të gjithë aktorëve në sistemin mbështetës, ndërgjegjësimi i qytetarëve, si dhe angazhimi i përbashkët për zgjidhjen e problemeve në komunitet.



